

Takimi i 17-të Koordinues midis Kryesisë së SEECP, Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal(RCC) dhe Bashkimit Evropian

Tiranë, 24 shkurt, 2015

Më 24 shkurt 2015 u mbajt në Tiranë, Takimi i 17-të koordinues me pjesëmarrjen e Kryesisë shqiptare të SEECP-së, për periudhën 2014-2015, Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe Bashkimit Evropian. Takimi u bashkë-kryesua nga Sekretari i Përgjithshëm i RCC-së dhe Koordinatori Kombëtar i SEECP/RCC-së në MPJ e Shqipërisë, në emër të Kryesisë së SEECP-së.

Sekretari i Përgjithshëm i RCC-së, pasi vlerësoi organizimin e aktiviteteve, theksoi bashkëpunimin dhe sinergjinë midis Sekretariatit të RCC-së dhe kryesisë shqiptare, duke shprehur gatishmërinë për të mbështetur dhe kontribuar në aktivitetet e ardhshme të kryesisë së SEECP-së.

Përfaqësuesi e kryesisë shqiptare, nënvizoi se marrëdhëniet me Sekretariatit e RCC-së, përfaqësojnë një pikë të fortë të kësaj kryesie dhe reflektoi mbi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal në kuadër të formatit të SEECP. U kërkua që mbështetja e RCC-së të vazhdojë edhe gjatë aktiviteteve të tjera të planifikuara, si dhe u nënvizua rëndësia e zgjidhjes së çështjes së pjesëmarrjes së Kosovës në kuadër të SEECP-së, sipas emërimit: "SEECP participants".

Duke iu referuar deklaratës së përbashkët kundër terrorizmit, Sekretari i Përgjithshëm i RCC-së, vuri në dukje detyrën e rëndësishme që kjo deklaratë i cakton RCC-së për të punuar në drejtim të përgatitjes së një platforme të bashkëpunimit rajonal për të adresuar çështjen e terrorizmit dhe luftëtarëve të huaj.

Përfaqësuesi i Kryesisë së SEECP-së nënvizoi rëndësinë që RCC, në bashkëpunim me aktoret e tjerë nga rajoni, të përgatisë një draft dokument sa më gjithëpërfshirës, i cili do të paraqitet ministrave të jashtëm për miratim gjatë takimeve të tyre të ardhshme.

Pjesëmarrësit vlerësuan punën serioze të kryesisë për përgatitjen e raportit të aktiviteteve të zhvilluara, si një dokument i cili do të pasurohet me të gjitha aktivitetet e parashikuara në kalendar, e që do të miratohet nga forumet e SEECP-së, në aktivitetet përmbyllëse të kësaj kryesie.

Gjate takimit u diskutua edhe lidhur me aktivitete që do të organizohen, ku një vend të veçantë zuri përgatitja për prezantimin e përbashkët SEECP-RCC në Komitetin e Jashtëm të Parlamentit Evropian. Palët përcaktuan disa nga çështjet kryesore që do të trajtohen gjatë këtij aktiviteti.

Përfaqësuesi i BE/KE përshëndeti deklaratën e Përbashkët kundër Terrorizmit dhe ritheksoi se SEECP mbetet një platformë unike dhe gjithëpërfshirëse e

bashkëpunimit rajonal në Europën Juglindore. Ai nënvizoi rëndësinë e SEECP-së si një projekt dhe proces bashkëpunimi që jep rezultate, dhe në të njëjtën kohë rekomandoi për një bashkëveprim më të ngushtë me BE. Përfaqësuesi i BE/KE gjithashtu përgëzoi Sekretarin e Përgjithshëm të RCC-së për bërjen e sekretariatit të RCC-së më efektiv.